



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1.15 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 30 të Rregullores mbi Organizmin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 1 shkurt 2018, merr këtë:

## V E N D I M

1. Miratohen propozimi për shpërndarjen e pozitave të lejuara për staf administrativ sipas Ligjit për Buxhetin për Vitin 2018 për Organizatën Buxhetor Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si në vijim:
  - 1.1. Për Sekretariatën e KGJK-së janë tridhjetepesë (35) pozita të cilat do të plotësohen me staf profesional dhe pozita për IT me qëllim të përmbushjes së obligimeve të marra nga KGJK sipas Marrëveshjes me Qeverinë Norvegjeze (SMIL);
  - 1.2. Për Zyrën e Prokurorit Disiplinor janë tre (3) pozita për Prokuror Disiplinor;
  - 1.3. Për Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Dhomën e Veçantë janë katër (4) pozita, nga të cilat një (1) pozitë për Bashkëpunëtor Profesional dhe dy (2) pozita për Zyrtar Ligjor në Gjykatën Supreme dhe nga një (1) pozitë për Bashkëpunëtor Profesional në Dhomën Veçantë;
  - 1.4. Për Gjykatën e Apelit janë pesëmbëdhjete (15) pozita, nga të cilat pesë (5) pozita janë për Bashkëpunëtor Profesional dhe dhjetë (10) pozita për Zyrtar Ligjor;
  - 1.5. Për Gjykatën Themelore në Prishtinë janë njëzeteshtatë pozita (27) pozita, nga të cilat gjashtëmbëdhjete (16) pozita janë për Bashkëpunëtor Profesional, një pozitë për zyrtar ligjor për degën në Lipjan dhe dhjetë (10) pozita për degën në F. Kosovë (dhe atë për këto pozita: një (1) pozitë Ndihmës administrator, një (1) pozitë Bashkëpunëtor Profesional, një (1) pozitë referent i lartë, një (1) pozitë referent për ekzekutime, një (1) pozitë zyrtar për përkthime, një (1) pozitë zyrtar për arkiv, dy (2) pozita zyrtar ligjor, një (1) pozitë për arkëtar dhe një (1) pozitë receptionist.

- 1.6. Për Gjykatën Themelore Prizren janë pesë (5) pozita, nga të cilat katër (4) pozita janë për Bashkëpunëtor Profesional dhe një (1) pozitë për Zyrtar Ligjor për degën në Dragash;
  - 1.7. Për Gjykatën Themelore Gjilan, janë gjashtë (6) pozita, nga të cilat katër (4) pozita për Bashkëpunëtor Profesional, një (1) për Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore dhe një (1) pozitë për Zyrtar Ligjor për degën në Kamenicë;
  - 1.8. Për Gjykatën Themelore Ferizaj janë katër (4) pozita, nga të cilat tre (3) pozita janë për Bashkëpunëtor Profesional dhe një (1) për Zyrtar Ligjor për degën në Shtërpçë;
  - 1.9. Për Gjykatën Themelore në Pejë janë katër (4) pozita për Bashkëpunëtor Profesional;
  - 1.10. Për Gjykatën Themelore në Gjakovë janë tre (3) pozita për Bashkëpunëtor Profesional;
  - 1.11. Për Gjykatën Themelore Mitrovicë janë gjashtë (6) pozita, nga të cilat katër (4) pozita janë për Bashkëpunëtor Profesional, një (1) pozitë për Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore dhe një (1) pozitë për degën në Vushtrri.
2. Pozitat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Vendimi për Gjykatat Themelore mund të zhvendosën në degët e gjykatave përkatëse apo anasjelltas, me propozim të Kryetarit të Gjykatës dhe pas aprovimit nga Drejtori i Sekretariatit të KGJK-së.
  3. Vendimi hyn në fuqi me datën 1 shkurt 2018.



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Kryetareve të gjykatave;
- Drejtorit të SKGJK-së;
- Departamentit të Administratës së Përgjithshme në SKGJK;
- Arkivit;